

AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“L&P COASTAL” SH.P.K.

Sot më datë, 16.04.2024, palët e mëposhtme,

1. **Z. Aleko Lika**, shtetas Shqiptar, lindur në Veterik, Berat, Shqipëri, më datë 05.05.1974, banues ne adresen: Rruga Antipatrea, Nd 158, H 1, 00010048, Berat, Shqiperi, mbajtës i kartës së identitetit me numër 034811135 dhe numër personal H40505270U, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
2. **Z. Bledar Paja Hajri**, shtetas i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, lindur në Shqipëri, më datë 14.07.1976, banues ne adresen: Nr. 20 Riverside Lane, is Block 11.04, Lot 18, Holmdelm, NJ 07733-2084, New Jersey, USA, mbajtës i pasaportës me numër 555779639, lëshuar nga Departamenti i Shtetit, i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, dhe legjislacionit të zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet nënshkrimit të këtij Akti Themelimi kanë vendosur të themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të emëruar “**L&P COASTAL**” Sh.p.k.. Aktiviteti i kësaj shoqërie do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj bashkalidhur këtij akti si Shtojca A, i cili konsiderohet pjesë thelbësore e Aktit të Themelimit.

Neni 1 – Emërtimi i Shoqërisë

- 1.1 Emri i shoqërisë është “**L&P COASTAL**” Sh.p.k, (këtu më poshtë e quajtur “**Shoqëria**”). Shoqëria është themeluar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin Shqiptar
- 1.2 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar dhe Statutin.
- 1.3 Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.
- 1.4 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 2 – Selia

- 2.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga “Hamdi Sina”, Liqeni i Thatë, Pallatet “Agi Bes Halili”, Pallati Nr 3, Ambjenti Nr 2, Nr pas 161/12 +2, ZK3266, Tiranë, Shqipëri.



- 2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të hapë dhe/apo mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, në Shqipëri apo jashtë saj. Ndërsa Administratori i Shoqërisë mund të çelë, transferojë dhe/apo mbyllë seli sekondare dhe/ose agjenci në Shqipëri.

Neni 3 – Kohëzgjatja

- 3.1. Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje të pakufizuar.
3.2. Shoqëria mund të prishet në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 4 – Objekti

- 4.1 Shoqëria ka për objekt parësor veprimtarie kryerjen e aktiviteteve të listuara më poshtë:
- i. Projektimi dhe ndertimi i objekteve civile apo industriale dhe administrimi i zbatimit të projekteve të kësaj natyre për vetë dhe për të tjerë;
 - ii. Investimi në projekte ndertimore me qëllim zhvillimin e zonave urbane, turistike apo rezidenciale apo investime të cilësdo natyre qoftë në zhvillimin e pasurive të paluajtshme në teresi;
 - iii. Shitja dhe / apo blerja, si dhe marrja apo dhënia me qira, e pasurive të paluajtshme, apo shitja ose blerja e projekteve të zhvillimit në veçanti;
 - iv. Administrimi, operimi dhe shfrytëzimi i pasurive të paluajtshme, si dhe ofrimi i shërbimeve të hoteleri-turizmit
 - v. Kryerjen e aktivitetit të ofrimit të shërbimit të konsulencës në fushën e biznesit, menaxhimit, taksave, vlerësimit të pasurive të paluajtshme etj.
 - vi. Për realizimin e objektit të veprimtarisë së saj, Shoqëria mund të kryejë gjithashtu, si aktivitet ndihmës dhe jo parësor, të gjitha veprimet mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, industriale, financiare dhe tregtare, në Shqipëri si dhe jashtë saj, në masën që vlerësohet e dobishme dhe/ose e përshtatshme nga organi administrativ dhe mundet gjithashtu të marrë përsipër, gjithmonë për qëllime ndihmëse, pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive ose ndërmarrjeve dhe ose entiteteve të tjera me objekt të ngjashëm, të afërt ose të lidhur me të vetin, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, si dhe çdo aktivitet tjetër të lejuar nga ligjet në fuqi.
 - vii. Shfrytëzimin e zonave bregdetare/plazheve në zonën e projektit për qëllime turistike, duke administruar, dhënie me qira, ndertuar objekte rekreative dhe duke ofruar shërbime në fushën e turizmit, argetimit, bar, restorante etj.



- viii. Të gjitha veprimtaritë e përshkruara më sipër mund të zhvillohen si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.
- ix. Shoqëria mund të bashkëpunojë dhe/ose blejë/përfitojë direkt ose indirekt pjesëmarrje, në shoqëri, ndërmarrje, agjenci apo sipërmarrje të tjera, të cilat kanë fushë veprimtarie të ngjashme.
- x. Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie apo transaksion tjetër që lidhet me pasuri të luajtshme e të paluajtshme, me kryerjen e veprime tregtare, industriale, bankare dhe/ose financiare të cfarëdo lloji dhe natyre, të nevojshme ose të dobishme për arritjen dhe ose plotësimin e objektivit të Shoqërisë, që nuk ndryshon aktivitetin parësor të Shoqërisë dhe nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 5 – Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerën **1,000,000 LEK (nje milion lekë)**, dhe është nënshkruar dhe merret përsipër për tu shlyer plotësisht me kontribute në para nga Ortakët, pas themelimit të Shoqërisë.
- 5.2 Kapitali i Shoqërisë, është i ndarë në 2 (dy) kuota, nga një për secilin Ortak të Shoqërisë dhe zotërohet si më poshtë:
 - **Ortaku, Z. Aleko Lika**, zotërues i 1 (një) kuote të Shoqërisë, me vlerë **490,000 Lekë**, (katerqind e nentdhjete mijë lekë), e cila përfaqëson **49% (dyzet e nëntë përqind)** të kapitalit themeltar, me të drejtë vote;
 - **Ortaku, Z. Bledar Paja Hajri**, zotërues i 1 (një) kuote të Shoqërisë, me vlerë **510,000 Lekë**, (peseqind e dhjete mijë lekë), e cila përfaqëson **51% (pesëdhjetë e një përqind)** të kapitalit themeltar, me të drejtë vote;
- 5.3 Përgjegjësia e Ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.
- 5.4 Shoqëria mund të marrë nga Ortakët hua dhe financime në favor të saj, me apo pa pagesë, me ose pa detyrim rimbursimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 5.5 Adresat e Ortakëve dhe administratorëve për marrëdhëniet e tyre me Shoqërinë, janë adresat që rezultojnë nga statuti ose akti i emërimit të tyre dhe ndryshimet nëse ka pasur më vonë.

Neni 6 – Transferimi i Kuotave

- 6.1. Kuotat e Shoqërisë mund të transferohen, tërësisht apo pjesërisht, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 8 të Statutit.



Neni 7 – Administratori/ët

- 7.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë. Në rast se ka më shumë se një Administrator, Administratorët do të veprojnë bashkarisht përveçse kur parashikohet ndryshe në aktin e emërimit të tyre. Administratorët do të qëndrojnë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me mundësi rizgjedhje. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit në detyrë, mandati i tyre do të rinovohet automatikisht edhe për një vit tjetër.
- 7.2 Administratori/ët përfaqëson ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushtron të gjitha fuqitë e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme.
- 7.3 Administratori/ët mund të emërojë përfaqësues me prokurë speciale (“*ad negotia*”) për kryerjen e një akti ose kategori aktesh në kufijtë e tagrave që u janë dhënë atyre.
- 7.4 Personi i mëposhtëm caktohet si Administratori i parë i Shoqërisë:
- **Z. Aleko Lika**, shtetas Shqiptar, lindur në Veterik, Shqipëri, më datë 05.05.1974, mbajtës i kartës së identitetit me numër 034811135 dhe numër personal H40505270U, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Neni 8 – Dispozita të Fundit

- 8.1 Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Akt Themelimi, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar.

* * *

NË DËSHMI TË SA MË SIPËR, Pala deklaron se ky Akti Themelimi dhe Statuti bashkangjitur si Shtojca A, është në përputhje me vullnetin e saj dhe për këtë arsye e nënshkruan atë në datën e sipërshtënuar, me vullnet të plotë dhe të lirë.

Z. ALEKO LIKA

Z. BLEDAR PAJA HAJRI

ALEKO LIKA




ANEKSI A

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “L&P COASTAL” SH.P.K.

KAPITULLI I EMËRTIMI, SELIA, KOHËZGJATJA DHE OBJEKTI

Neni 1 – Emërtimi i Shoqërisë

- 1.1 Emri i shoqërisë është “L&P COASTAL” Sh.p.k, (këtu më poshtë e quajtur “Shoqëria”). Shoqëria është themeluar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin Shqiptar
- 1.2 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar dhe Statutin.
- 1.3 Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

Neni 2 – Selia

- 2.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga “Hamdi Sina”, Liqeni i Thatë, Pallatet “Agi Bes Halili”, Pallati Nr 3, Ambjenti Nr 2, Nr pas 161/12 +2, ZK3266, Tiranë, Shqipëri.
- 2.2 Shoqëria rezervon të drejtën të zhvendosë selinë e saj në një adresë tjetër në Shqipëri
- 2.3 Asambleja e Përgjithshme mund të hapë dhe/apo mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, në Shqipëri apo jashtë saj. Ndërsa Administratori i Shoqërisë mund të çelë, transferojë dhe/apo mbyllë seli sekondare dhe/ose agjenci në Shqipëri.

Neni 3 - Kohëzgjatja

- 3.3. Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje të pakufizuar.
- 3.4. Shoqëria mund të prishet në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.



Neni 4 – Objekti

- 4.1 Shoqëria ka për objekt parësor veprimtarie kryerjen e aktiviteteve të listuara më poshtë:
- i. Projektimi dhe ndertimi i objekteve civile apo industriale dhe administrimi i zbatimit të projekteve të kësaj natyre për vetë dhe për të tjerë;
 - ii. Investimi në projekte ndertimore me qëllim zhvillimin e zonave urbane, turistike apo rezidenciale apo investime të cilësdo natyre qoftë në zhvillimin e pasurive të paluajtshme në teresi;
 - iii. Shitja dhe / apo blerja, si dhe marrja apo dhënia me qira, e pasurive të paluajtshme, apo shitja ose blerja e projekteve të zhvillimit në veçanti;
 - iv. Administrimi, operimi dhe shfrytëzimi i pasurive të paluajtshme, si dhe ofrimi i shërbimeve të hoteleri-turizmit
 - v. Kryerjen e aktivitetit të ofrimit të shërbimit të konsulencës në fushën e biznesit, menaxhimit, taksave, vlerësimit të pasurive të paluajtshme etj.
 - vi. Për realizimin e objektit të veprimtarisë së saj, Shoqëria mund të kryejë gjithashtu, si aktivitet ndihmës dhe jo parësor, të gjitha veprimet mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, industriale, financiare dhe tregtare, në Shqipëri si dhe jashtë saj, në masën që vlerësohet e dobishme dhe/ose e përshtatshme nga organi administrativ dhe mundet gjithashtu të marrë përsipër, gjithmonë për qëllime ndihmëse, pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive ose ndërmarrjeve dhe ose entiteteve të tjera me objekt të ngjashëm, të afërt ose të lidhur me të vetin, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, si dhe çdo aktivitet tjetër të lejuar nga ligjet në fuqi.
 - vii. Shfrytëzimin e zonave bregdetare/plazheve në zonën e projektit për qëllime turistike, duke administruar, dhënie me qira, ndertuar objekte rekreative dhe duke ofruar shërbime në fushën e turizmit, argetimit, bar, restorante etj.
 - viii. Të gjitha veprimtaritë e përshkruara më sipër mund të zhvillohen si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.
 - ix. Shoqëria mund të bashkëpunojë dhe/ose blejë/përfitojë direkt ose indirekt pjesëmarrje, në shoqëri, ndërmarrje, agjenci apo sipërmarrje të tjera, të cilat kanë fushë veprimtarie të ngjashme.
 - x. Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie apo transaksion tjetër që lidhet me pasuri të luajtshme e të paluajtshme, me kryerjen e veprime tregtare, industriale, bankare



dhe/ose financiare të cfarëdo lloji dhe natyre, të nevojshme ose të dobishme për arritjen dhe ose plotësimin e objektivit të Shoqërisë, që nuk ndryshon aktivitetin parësor të Shoqërisë dhe nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR, RRRITJA DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

Neni 5 – Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerën 1,000,000 LEK (nje milion lekë), dhe është nënshkruar dhe marret përsipër për tu shlyer plotësisht me kontribute në para nga Ortakët, pas themelimit të Shoqërisë.
- 5.2 Kapitali i Shoqërisë, është i ndarë në 2 (dy) kuota, nga një për secilin Ortak të Shoqërisë dhe zotërohet si më poshtë:
- **Ortaku, Z. Aleko Lika**, zotërues i 1 (një) kuote të Shoqërisë, me vlerë 490,000 Lekë, (katerqind e nentëdhjete mijë lekë), e cila përfaqëson 49% (dyzet e nëntë përqind) të kapitalit themeltar, me të drejtë vote;
 - **Ortaku, Z. Bledar Paja Hajri**, zotërues i 1 (një) kuote të Shoqërisë, me vlerë 510,000 Lekë, (peseqind e dhjete mijë lekë), e cila përfaqëson 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit themeltar, me të drejtë vote;
- 5.3 Përgjegjësia e Ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.
- 5.4 Shoqëria mund të marrë nga Ortakët hua dhe financime në favor të saj, me apo pa pagesë, me ose pa detyrim rimbursimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 5.5 Adresat e Ortakëve dhe administratorëve për marrëdhëniet e tyre me Shoqërinë, janë adresat që rezultojnë nga statuti ose akti i emërimit të tyre dhe ndryshimet e mëvonëshme.

Neni 6 – Rritja e kapitalit themeltar

- 6.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.
- 6.2 Kapitali nuk mund të zmadhohet për sa kohë nuk është përmbushur detyrimi për të paguar kuotat e nënshkruara më parë nga Ortakët e Shoqërisë.



Neni 7 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 7.1 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë të zvogëlojë kapitalin themeltar. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 7.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga Ortakët e Shoqërisë në të njëjtën masë me pjesën e kapitalit të zotëruar prej tyre.

Neni 8 – Transferimi i kuotave

- 8.1 Me përjashtim të rastit kur me unanimitet Ortakët vendosin ndryshe, Ortakët nuk mund të vënë peng, barrë siguroese ose çfarëdolloj barre tjetër mbi kuotat e Shoqërisë dhe as mbi asetet e saj që fitohen gjatë Kohëzgjatjes së Shoqërisë me qëllim të realizimit të Projektit të lartpërmendur .
- 8.2 Me përjashtim të rastit kur me unanimitet Ortakët vendosin ndryshe, nuk mund të transferohet e drejta e pronësisë mbi kuotat e Shoqërisë nga asnjëri prej Ortakëve tek palët e treta nëpërmjet (i) një akti dhurimi/ pa pagesë inter vivos, (ii) një akti shkëmbimi (ex neni 757 i Kodit Civil), (iii) një kontributi në Shoqëri të treta ose (iv) çfarëdolloj akti tjetër që drejtëpërsëdrejti ose indirekt realizon transferimin e pronësisë së ortakëve të Shoqërisë tek të tretët.
- 8.3 Kuotat e Shoqërisë janë të transferueshme inter vivos, kundrejt pageses, sipas procedurës së përcaktuar nga paragrafët në vijim të këtij neni, duke konsideruar ndalimin/përjashtimin nga transferimi sipas pikës 8.2 më sipër.
- 8.4 Ortaku që synon të transferojë të drejtën e pronësisë mbi kuotën që zotëron (në vijim "Ortaku Shitës"), duhet të njoftojë paraprakisht me shkrim të gjithë Ortakët e tjerë (në vijim "Ortakët e Tjerë") nëpërmjet një letre rekomande me njoftim marrjeje (në vijim "Njoftimi") të dërguar në adresën përkatëse të Ortakëve. Njoftimi duhet të përmbajë çmimin e kalimit të kuotës.
- 8.5 Ortakët e Tjerë do të kenë të drejtë të blejnë kuotën e ofruar, me të njëjtin çmim sikurse të përcaktuar në Njoftim dhe në asnjë rast, përveçse kur pala përkatëse bie dakord në formë të shkruar, palës së tretë nuk do t'i ofrohen kushte më të favorshme shitje në krahasim me ato që i ofrohen ortakëve të tjerë të Shoqërisë. Nëse cilido prej Ortakëve të Tjerë synon të ushtrojë të drejtën e parablerjes, duhet të njoftojë Ortakun Shitës me letër rekomande me njoftim marrjeje brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së Njoftimit. Në të kundërt, do të konsiderohet se është hequr dorë prej së drejtës së parablerjes.
- 8.6 Nëse më shumë se një prej Ortakëve të Tjerë ka ushtruar të drejtën e parablerjes, kuotat e ofruara do të blihen prej tyre në përpjesëtim me kuotat përkatëse që ata zotërojnë në Shoqëri me të njëjtat kushte dhe afate të propozuar nga i treti, Ortaku Shitës.



- 8.7 Nëse asnjë prej Ortakët të Tjerë nuk ushtron të drejtën e parablerjes brenda afatit të sipërshënuar, Ortaku Shitës do të jetë i lirë të shesë/transferojë tek i treti kuotën e përcaktuar në Njoftim, i cili duhet të përmbajë: (i) emrin e të tretit blerës, (ii) çmimin për transferimin e kuotës. Transferimi i kuotës së zotëruar nga ortaku do të kryhet vetëm pas miratimit unanimit nga Asambleja të çmimit të shitjes dhe i palës blerëse, i cili nuk duhet të jetë më i ulët nga ai i përcaktuar në nenin 8.4. Miratimi nga Asambleja nuk do të vonohet apo pengohet pa shkaqe të arsyeshme, të cilat mund të lidhen vetëm me rregullsinë e transaksionit.
- 8.9 Kushtet e parashikuara më sipër nuk do të zbatohen në rast transferimi të kuotave nga një Ortak tek një Shoqëri e cila ndodhet nën kontrollin e këtij Ortaku ose kontrollon këtë ortak ose në rast transferimi nga një Ortak tek një pasardhës ose paraardhës i drejtpërdrejtë i tij ose tek bashkëshorti, nëse është dhënë pëlqimi me shkrim nga të gjithë Ortakët e shoqërisë. Në këtë Statut, fjala “kontroll” ka të njëjtin kuptim të përdorur në ligjin tregtar.

KAPITULLI III

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL

Neni 9 – Asambleja e Përgjithshme dhe kompetencat e saj

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë.
- 9.2 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, të marra në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me dispozitat e këtij Statuti, janë të detyrueshme për të gjithë Ortakët, pavarësisht janë apo jo të pranishëm në mbledhje, janë apo jo dakord me këto vendime.
- 9.3 Asambleja e Përgjithshme ka funksionet e mëposhtme:
- Përcakton politikat tregtare dhe ekonomike të Shoqërisë dhe mbikqyr zbatimin e tyre nga Administratori duke përfshirë raportimet financiare;
 - Emëron dhe shkarkon Administratorin(-ët);
 - Emëron dhe shkarkon ekspertin(-ët) kontabël dhe/ose likuiduesin(-ët) e Shoqërisë;
 - Përcakton pagat dhe shpërblimet për Administratorin(-ët), ekspertët(-ët) kontabël dhe likuiduesit(-ët) e Shoqërisë;
 - Miraton pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë të përgatitura nga Administratori;
 - Merr vendim për ndryshimet e këtij Akti Themelimi dhe Statuti të Shoqërisë;

- Merr vendim për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;
- Merr vendim për shpërndarjen e fitimeve, dividendëve;
- Merr vendim për ristrukturimin e Shoqërisë ose prishjen e saj;
- Merr vendim për pjestimin e kuotave;
- Merr vendim për hapjen e degëve dhe/ose zyrave të përfaqësimit të Shoqërisë brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë;
- Merr vendim për themelimin e shoqërive të reja Joint Venture ose aleanca që lidhen me shitjen blerjen, pjesëmarrjen dhe investimin në projekte ekzistuese dhe të reja;
- Vendos për dhënien dhe marrjen e fondeve hua ose paradhënie nga ortakët dhe administratorët për nevoja personale dhe për financim biznesi;
- Miraton kërkesat e reja dhe vendos për rinovimin e kërkesave ekzistuese për financim;
- Vendos për bllokimin dhe lënien peng të pasurive të paluajtshme pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;
- Vendos për emërimin dhe shkarkimin e Drejtorëve të Financës dhe zëvendësve të Administratorit;
- Vendos për prishjen/likuidimin e Shoqërisë;
- Miraton buxhetin vjetor të shoqërisë;
- Miraton investimet dhe shpenzimet të cilat nuk janë parashikuar në buxhetin vjetor;
- Vendos për blerjen e pasurive të paluajtshme;
- Miraton planin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë;
- Merr vendim për çdo çështje tjetër të parashikuara nga ligji.

9.4 Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve mund të marrë vendime në mënyrë të vlefshme në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9901, datë 14 mars 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

Neni 10 - Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi dhe vendimet

- 10.1 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të thirret nga Administratori/(-rët) apo prej Ortakëve zotërues të të paktën 5% të votave sipas legjislacionit në fuqi.
- 10.2 Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkrim me lajmërim marrje, ose postë elektronike me lajmërim marrje. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet




- të përmbajë vendin, datën, orën dhe rendin e ditës dhe duhet t'u dërgohet Ortakëve brenda 5 (pesë) ditëve para datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.
- 10.3 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme zhvillohet normalisht në selinë e Shoqërisë ose në një vend tjetër brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.
- 10.4 Asambleja e Përgjithshme shprehet në mënyrë të veçantë për çdo çështje të rendit të ditës, për të cilën duhet të merret një vendim i veçantë.
- 10.5 Ortakët mund të marrin pjesë në Asamblenë e Përgjithshme personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë/autorizim me shkrim. Administratori/(-ët) e Shoqërisë nuk mund të përfaqësojnë Ortakët në Asamblenë e Përgjithshme.
- 10.6 Ortakët që nuk janë të pranishëm mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike të audiove dhe video-konferencës. Përdorimi i mjeteve elektronike për t'u mundësuar Ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë Përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e Ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.
- 10.7 Asambleja e Përgjithshme konsiderohet e thirrur dhe zhvilluar rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të gjithë kapitalin themeltar dhe të gjithë ortakët janë dakord të vijojnë me mbledhjen pavarësisht parregullsive të njoftimit.

Neni 11-Largimi i Ortakut të Shoqërisë

- 11.1 Ortaku mund të largohet nga Shoqëria në rast se:
- i. Ortakët e tjerë apo Shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, me faj ose nga pakujdesia;
 - ii. Është penguar të ushtrojë të drejtat e tij sipas këtij Statuti dhe Akti Themelimi;
 - iii. Shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme;
 - iv. Ekzistojnë shkaqe të tjera që e bëjnë të pamundur vazhdimësinë e Ortakërisë në këtë Shoqëri ose është shkelur parimi i mirëbesimit dhe i qëllimit për të cilin është formuar kjo Ortakëri.
- 11.2 Për ushtrimin e të drejtës së largimit zbatohet Ligji 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".



Administratori/(-ët) thërrasin mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme menjëherë pas komunikimit të njoftimit të largimit për të vendosur nëse Ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.

- 11.3 Për vlerësimin e çmimit të kuotës të Ortakut të dorëhequr që duhet shlyer, do të merret parasysh vlera sipas kërkesës së tregut në shit-blerjen e kuotave në momentin e largimit të Ortakut.

Neni 12 – Administratori/ët

- 12.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë. Në rast se ka më shumë se një Administrator, Administratorët do të veprojnë bashkërisht përveçse kur parashikohet ndryshe në aktin e emërimit të tyre. Administratorët do të qëndrojnë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me mundësi rizgjedhje. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit në detyrë, mandati i tyre do të rinovohet automatikisht edhe për një vit tjetër.
- 12.2 Administratori/ët përfaqëson ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushtron të gjitha fuqitë e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme.
- 12.3 Administratori/ët mund të emërojë përfaqësues me prokurë speciale (“ad negotia”) për kryerjen e një akti ose kategori aktesh në kufijtë e tagrave që u janë dhënë atyre.
- 12.4 Administratori është përgjegjës ndaj Shoqërisë për çdo veprim apo mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 12.5 Administratori ka të drejtë të rimburohet për shpenzimet e kryera për shkak të funksionit të tij si dhe të marrë një shpërblim, masa e të cilit do të përcaktohet me një Marrëveshje të veçantë të miratuar me Vendim të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë.
- 12.6 Çdo veprim i Administratorit apo kompetencë e tij do të ushtrohet individualisht, me përjashtim të rasteve kur Asambleja e Përgjithshme vendos ndryshe në përputhje me dispozitat e këtij Statuti ose në bazë të ligjit përkatës.



Neni 13 – Eksperti kontabël i autorizuar

- 13.1 Nëse është e nevojshme/kërkohet nga ligji ose vendoset nga Asambleja e Përgjithshme, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë kryhet nga një ose disa ekspertë kontabël të autorizuar.
- 13.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni përkatës.

KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 14 – Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor

- 14.1 Viti financiar i Shoqërise zgjat 12 Muaj dhe fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.
- 14.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.
- 14.3 Asambleja e Përgjithshme miraton bilancin vjetor, pasqyrat financiare, inventarin, raportet e Administratorit/ëve dhe të ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar).
- 14.4 Dokumenta që lidhen me vitin financiar duhet të miratohen brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Neni 15 – Fitimet

- 15.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor përdoren në përputhje me vendimin e marrë nga Asambleja e Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë, për qëllime të posaçme, krijimin e rezervave të posaçme apo të jashtëzakonshme ose të shtyjë ri-investimin e fitimeve, tërësisht apo pjesërisht.
- 15.2 Fitimet do të përdoren në përputhje me Objektin e Shoqërisë përcaktuar në Nenin 4 të këtij Statuti dhe në veçanti në përputhje me parimet dhe praktikat e biznesit social.
- 15.3 Fitimi neto ne Shoqeri do te shperndahet ne perputhje me pjeset e kapitalit ne Shoqeri

KAPITULLI V



SHPËRNDARJA DHE LIKUJDIMI

Neni 16 – Shpërndarja

- 16.1 Shoqëria mund të priset me vendim të Asamblesë së Përgjithshme apo në rastet e parashikuara nga ligji.
- 16.2 Shoqëria nuk priset për shkak të paaftësisë për të vepruar, pengesave ligjore, vdekjes, likuidimit apo falimentimit të ortakëve.

Neni 17 – Likuidimi

- 17.1 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likuidohet.
- 17.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Përgjithshme emëron një ose disa likuidues të cilët do të paraqesin raportin përfundimtar të likuidimit mbi asetet dhe detyrimet e Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme të likuidimit.
- 17.3 Në fund të procedurës së likuidimit, Asambleja e Përgjithshme vendos në lidhje me bilancin përfundimtar, punën e kryer nga likuiduesi/t dhe përfundimin e procesit të likuidimit, si dhe riinvestimin në biznese sociale të shumave eventualisht të mbetura pas likuidimit të cilat tejkalojnë kapitalin që ortakët kanë investuar, duke përcaktuar modelitet e nevojshme për këtë qëllim.
- 17.4 Pas pagesës së kreditorëve dhe mbledhjes së kredive të maturuara, likuiduesi/t u shpërndajnë ortakëve asetet e mbetura në përputhje me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme marrë në bazë të nenit 17.3 më sipër.

KAPITULLI VI TË NDRYSHME

Neni 18 – Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- 18.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Statuti, do të zgjidhen në mënyrë miqësore nga palët e interesuara.
- 18.2 Nëse mosmarrëveshja nuk zgjidhet në mënyrë miqësore, ajo i paraqitet Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, përveç kur ndonjë prej ortakëve vendos t'ia nënshtrorë zgjidhjen e



mosmarrëveshjes një Gjykate Arbitrazi.

18.3 Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Akt Themelimi e Statut, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar.

Tiranë më 16.04.2024

Z. ALEKO LIKA

ALEKO LIKA


Z. BLEDAR PAJA HAJRI

